**VENDIM**
**Nr.14, datë 9.3.2011**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN "MBI TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 53 pika 4, të shkronjës "e", të pikës 1 të nenit 55, të nenit 56 pika 2, neneve 69, 124, dhe 125 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare" miratuar me vendimin nr.59, datë 29.8.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshime e mëposhtme:

a) Në nenin 4, shtohen respektivisht shkronja "c" dhe "d" me përmbajtjen e mëposhtme:

"c)… "normë fikse e interesit për kreditë" është norma e interesit, për të cilën banka dhe kredimarrësi bien dakord në marrëveshjen e kredisë, që të jetë një përqindje fikse e pandryshuar për gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes së kredisë ose disa përqindje fikse të pandryshuara për periudha të pjesshme.

d… "normë e ndryshueshme e interesit për kreditë" është norma e interesit, për të cilën banka dhe kredimarrësi bien dakord në momentin e nënshkrimit/lidhjes së marrëveshjes/kontratës së kredisë, e cila llogaritet mbi bazën e një indeksi orientues dhe një marzhi fiks."

b) Në nenin 5, paragrafi 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Bankat publikojnë dukshëm dhe qartësisht në faqet e tyre të internetit dhe në ambientet e tyre të punës informacionin mbi normat e interesit të kredive dhe depozitave, si dhe komisionet për produktet dhe shërbimet që ato ofrojnë për klientët.".

c) Në nenin 5, shtohen paragrafët 8, 9, 10 dhe 11 me përmbajtjen e mëposhtme:

"8. Bankat hartojnë dhe miratojnë sipas mënyrave të parashikuara në rregulloret e tyre të brendshme metodën/politikën e llogaritjes:

a) të normave të interesave për kreditë dhe depozitat;

b) të komisioneve për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare.

9. Bankat nuk ndryshojnë, pa pëlqimin e klientit, gjatë kohëzgjatjes së kontratës/marrëveshjes së kredisë metodën/metodologjinë e llogaritjes së normës së interesit dhe/ose elementet përbërëse të saj, për të cilën/at është rënë dakord me klientët në momentin e lidhjes të marrëveshjes/kontratës së kredisë.

10. Banka paraqet pranë Bankës së Shqipërisë raportet në baza tremujore mbi normat e interesave për kreditë dhe depozitat dhe komisionet për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare që ajo i ofron klientëve. Këto raporte paraqiten brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas përfundimit të periudhës tremujore, sipas formës së raportimit të miratuara nga Banka e Shqipërisë.

11. Banka e Shqipërisë publikon në mënyrë të përmbledhur dhe krahasimore normat e interesave për kreditë dhe depozitat dhe komisionet për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare të raportuara për të gjitha subjektet.".

d) Në nenin 6, paragrafi 10 ndryshon si më poshtë:

"10 Banka e Shqipërisë publikon të dhëna mbi normat efektive të interesit, të raportuara nga subjektet e kësaj rregulloreje, duke ruajtur sekretin e informacionit për klientin/ët.

e) Në nenin 7, paragrafi 1, shkronja "c" ndryshohen si më poshtë:

"c) kushtet e kredisë që lidhen me vlerën, njësinë monetare, datën e dhënies, datën e maturimit, normën nominale vjetore të interesit dhe llojin e saj (e ndryshueshme ose e pandryshueshme), indeksin orientues (norma e marrëveshjes së riblerjes e Bankës së Shqipërisë, norma e bonove të thesarit, libor, euribor, tribor) marzhi, normën efektive të interesit, frekuencën e ndryshimit të normës së interesit apo pjesëve përbërëse të saj. Vlerën periodike të shlyerjes së kredisë

(kësti) dhe datat ose periudhën e shlyerjes".

f) Në nenin 8, pika 1 paragrafi i parë ndryshon si më poshtë:

"1. Banka, në rast të aplikimit të një norme të ndryshueshme interesi, i siguron me shkrim kredimarrësit të paktën një herë në 12 muaj, informacionin e mëposhtëm…"

g) Në nenin 8, paragrafi 2 shfuqizohet.

2. Autorizohet Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë të miratojë përmbajtjen dhe formën e raportimit të përcaktuar në nenin 5, paragrafi 10 i kësaj rregulloreje.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e ndryshimeve dhe shtesave të rregullores "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare" të miratuara me këtë vendim në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit të Fletores Zyrtare.

KRYETARI
**Ardian Fullani**